

Nismë Transatlantike për Bisedimet Kosovë-Serbi

Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse (CIG), në bashkëpunim me dhe mbështetur nga Fondi Vëllezërit Rockefeller (RBF), organizoi diskutimin e dytë¹ përmes platformës Zoom më 2 tetor 2020 për një numër ish-diplomatësh të nivelit lartë të SHBA dhe Evropës lidhur me bisedimet Kosovë-Serbi. Pjesëmarrësit sugjeruan që të gjitha palët—Prishtina, Beogradi, SHBA dhe BE—duhet të punojnë së bashku për të arritur një marrëveshje përfundimtare midis dy vendeve. Pjesëmarrësit rekomanduan që SHBA dhe BE duhet të bien dakord mbi një sërë parimesh negociuese dhe të drejtojnë procesin e negociatave bashkarisht.

Një marrëveshje e denjë për paqe do të eliminonte të gjitha kërcënimet ekzistuese dhe të mundshme ndaj marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, si dhe të paqes në rajon në të ardhmen. Për të arritur një marrëveshje të tillë, të gjitha palët—Serbia, Kosova, SHBA dhe BE—duhet të bëjnë disa ndryshime në politikat e tyre. Njohja e Serbisë është një element kryesor për paqen e vërtetë. Por Serbia po kërkon diçka në këmbim. Kosova nuk ka asgjë për t'i dhënë Serbisë—megjithëse do të mund të akomodonte më mirë komunitetin serb—por BE ka shumë gjëra që Serbia i dëshiron dhe i duhen. Për dallim nga BE, “SHBA ka më pak leva në negociim sesa BE, e cila ka karrotën e anëtarësim”, mirëpo edhe SHBA ka ndikimin të madh politik si në Prishtinë ashtu edhe në Beograd.

Ky raport bazohet në diskutimet e mbajtura nën Rregullën Chatham House. Përmbajtja prezanton një përmbledhje të pikëpamjeve të pjesëmarrësve të ndryshëm dhe nuk bazohet në konsensus. Pjesëmarrësit morën pjesë në cilësinë personale. CIG është përpjekur të jetë i saktë dhe i ekuilibruar në përmbledhjen e pikave të diskutimit dhe kërkon mirëkuptim nga pjesëmarrësit, mendimet e të cilëve mund të mos jenë përfshirë plotësisht në këtë raport të shkurtë. Raporti nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e pjesëmarrësve individualë, të CIG apo të RBF..

Shumë pjesëmarrës thanë se për të pasur sukses, një iniciativë eventuale e përbashkët transatlantike kërkon një vizion dhe angazhim të guximshëm. Qëllimi afatmesëm duhet të jetë të ndihmojmë Serbinë dhe Kosovën të bëhen kandidatë më të besueshme për anëtarësim në BE. Synimi përfundimtar duhet të jetë anëtarësimi i të dy vendeve në BE si dy shtete të pavarura që njohin njëra-tjetrën dhe gëzojnë marrëdhënie të fqinjësisë së mirë.

- SHBA dhe BE duhet të bien dakord mbi një vizion të përbashkët për marrëveshje dhe mbi një mekanizëm për zbatimin të saj. SHBA dhe BE duhet t'i bëjnë negociatat në një ndërmarrje të përbashkët, duke u zotuar për veprim konsensual, koordinim dhe konsulta të rregullta, ngjashëm me negociatat e Vjenës në vitin 2007. Të dy vendet synojnë të hyjnë në BE, por BE po humbet gjithnjë e më shumë fuqinë e saj. "SHBA mbetet fuqia e vetme e madhe që ka rol të rëndësishëm në rajon," shtoi një pjesëmarrës.

¹ Për raporting e diskutimit të parë, vizitoni: <http://www.cigonline.net/transatlantic-relations-and-the-western-balkans/>.

- Plani SHBA-BE duhet të përcaktojë qëllimin përfundimtar: njohjen e ndërsjellë dhe integrimin në BE për Serbinë dhe Kosovën. BE dhe SHBA duhet gjithashtu të ndihmojnë Serbinë dhe Kosovën në luftën kundër korrupsionit dhe forcimin e sundimit të ligjit për t'i përgatitur më mirë gjatë rrugëtimit për anëtarësim në BE.
- SHBA dhe BE duhet të ndërmjetësojnë mundësinë që Kosova dhe Serbia të arrijnë një marrëveshje, dhe të angazhohen në një kornizë dhe kalendar për arritjen e një marrëveshje paqeje.

Një rajon i qëndrueshëm dhe demokratik është në interes të BE dhe SHBA. Anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare, të tilla si Interpol, do të kontribuonte në sigurinë e rajonit. Prandaj, SHBA dhe BE duhet të punojnë për ta ndihmuar Kosovën të anëtarësohet në këto organizata ndërkombëtare.

Sfidat deri ne arritjen e një marrëveshjeje

Sfida kryesore për përfundimin e konfliktit përmes një marrëveshjeje paqeje është që Serbia dhe Kosova nuk janë demokraci të zhvilluara. Elitat e tyre politike mbeten më të interesuara për ruajtjen e pushtetit sesa për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Konflikti ndihmon elitat të shmangin vëmendjen e publikut nga çështjet e korrupsionit, krimit të organizuar dhe papunësisë. Shumë besojnë se udhëheqësit mendojnë se sundimi i ligjit kërcënon fuqinë e tyre. Paralelisht me lehtësimin e një procesi negociues, iniciativa SHBA-BE duhet të bëjë presion mbi Serbinë dhe Kosovën për të adresuar çështjet e sundimit të ligjit.

Gjatë diskutimit, pati edhe pika të ngritura nëse procesi i dialogut duhet të ecë me hapa të ngadaltë, apo të ketë një 'shpërthim të madh'. Disa thanë që një proces me hapa të ngadaltë nuk funksionon më. "Modeli i dialogut në Bruksel ka mbijetuar dobinë e tij." Mangësitë kryesore të modelit të hapave të ngadaltë janë se ai ofron një proces pa kalendar dhe me një dialog të pa përfund. Kjo është pikërisht ajo që preferojnë udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë. Pjesëmarrësit u pajtuan që procesi i vjetër i Brukselit ka arritur rezultate të konsiderueshme dhe mund të ketë qenë modeli i duhur në vitin 2010, kur Prishtina dhe Beogradi nuk kishin asnjë komunikim mes vete. Shumica e pjesëmarrësve poashtu kritikuan iniciativën e Trump e cila prodhoi disa letra zotimi të nënshkruara ndaras nga Beogradi dhe Prishtina por pa ndonjë angazhim të qartë për zbatim. Shumica e pjesëmarrësve sugjeruan që tani është koha për një proces më të guximshëm, një proces që shpie në një 'shpërthim të madh' dhe zgjidh çështjen e dialogut njëherë e përgjithmonë.

Modeli i rekomanduar 'shpërthim i madh' duhet të synojë mosmarrëveshjen e statusit ballë për ballë. Parimi i elementit multi-etnik duhet të jetë në thelb të procesit negociues. Për të pasur sukses, SHBA dhe BE duhet të rrisin presionin e tyre ndaj palëve në konflikt përmes një kombinimi të "shkopinjve dhe karrotave". Megjithëse Brukseli dhe Uashingtoni nuk duket se e shohin urgjencën në zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje Ballkanike, shumë pjesëmarrës konstatuan se zgjidhja e konfliktit është një interes i sigurisë transatlantike. Iniciativa SHBA-BE duhet të ketë një strategji të përbashkët, një natyrë urgjence, një kalendar dhe një angazhim të përbashkët, në mënyrë që të ketë marrëveshje të arritur dhe të zbatueshme.

Megjithëse ekziston një marrëveshje e gjerë, ku thuhet se rezoluta përfundimtare duhet të përfshijë njohjen, politikëbërësit ndërkombëtarë dhe vendorë kanë paraqitur rrugëtime të ndryshme për të arritur deri në atë pikë. Skenari i preferuar i Serbisë për ndarje nuk është i preferuar nga bashkësia ndërkombëtare. Mund të jetë si opsion në listë, por vetëm si i listuar në fund, tha një folës. Synimi

i bashkësisë ndërkombëtare nuk duhet të jetë krijimi i kufijve të rinj, por bërja e atyre ekzistues të parëndësishëm. Zbatimi i parimit të rregullimit të kufijve dhe izolimi i pasojave të këtij parimi vetëm në Kosovë është pothuajse e pamundur, argumentuan disa pjesëmarrës. Sidoqoftë, një pjesëmarrës tjetër tha që nëse Serbia, Kosova dhe ndërmjetësuesit ndërkombëtarë bien dakord se "ky është ndryshimi i fundit i kufirit në rajon", nuk do të kishte pasoja rajonale. Shumica dërmuese e pjesëmarrësve sugjeruan fuqishëm që ky opsion të mos konsiderohej fare nga SHBA dhe BE.

Një tjetër mundësi është që Kosova të ofrojë të drejta shtesë për serbët e Kosovës përmes themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Disa sugjeruan që formimi i Asociacionit duhet të jetë pjesë e marrëveshjes përfundimtare.

Duke qenë se Kosova dhe Serbia nuk ka të ngjarë të gjejnë një zgjidhje të vetme, një veprim i përbashkët SHBA-BE është i pashmangshëm. Disa folës thanë se procesi i dialogut ka nevojë për një impuls. Një pjesëmarrës sugjeroi që çmontimi i UNMIK-ut dhe ofrimi i anëtarësimit të Kosovës në OKB është një impuls i tillë. Një tjetër pjesëmarrës sugjeroi zhvendosjen e fokusit nga diskutimet e mosmarrëveshjeve të statusit në lëvizjen e njerëzve, mallrave dhe kapitalit dhe fuqizimin e popullatave. Prosesi i Berlinit është një mekanizëm i mirë për zbatimin e ideve të tilla. Sundimi i ligjit duhet gjithashtu të bëhet prioriteti kryesor i bashkësisë ndërkombëtare. "Në rend të parë sundimi i ligjit, në rend të dytë marrëveshja gjithëpërfshirëse."

Më poshtë janë disa nga elementet e përmendura gjatë diskutimit për marrëveshjen:

- BE t'u bëjë të qartë të dy palëve se nuk pranon "demokraci joliberalë" në union. Serbia duhet ta dijë që me ritmin e saj aktual mbi reformat e sundimit të ligjit, do t'i duhen dekada për të arritur kriteret e anëtarësimit në BE. BE mund të ofrojë më shumë mbështetje për përmbushjen e kriterëve, por kjo nuk do ta lehtësonte kushtëzimin.
- SHBA dhe BE të bien dakord mbi parimet e përbashkëta udhëzuese mbi të cilat bazohet një marrëveshje. Sapo SHBA dhe BE të bien dakord mbi veprimin e përbashkët, do të ishte shumë më e lehtë të bindnin Kosovën dhe Serbinë për bisedime dhe përfundimisht të binin dakord për një marrëveshje përfundimtare. Nëse SHBA dhe BE bashkëpunojnë, do të mund të kenë më shumë ndikim sesa nëse vepronë ndaras.
- Kosova të themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, siç është rënë dakord në vitin 2013 në Bruksel.
- Serbia në një periudhë afatmesme të heqë dorë nga pretendimi i saj për Kosovën përgjatë linjës së modelit "dy Gjermanitë" ose të ashtuquajturit 'normalizim pa njohje', por Beogradit duhet t'i bëhet e qartë se zgjidhja përfundimtare duhet të përfshijë njohjen.
- Pesë shtetet anëtare të BE që nuk e njohin Kosovën, të zotohen ta njohin sapo të përfundojë një marrëveshje midis Prishtinës dhe Beogradit.
- BE-ja ta ndihmojë Serbinë më shumë për të përmbushur kriteret e saj të anëtarësimit në BE.
- SHBA dhe BE të ofrojnë mbështetje të madhe financiare për Serbinë dhe Kosovën bazuar në parimin 'më shumë për më shumë'—rritjen e mbështetjes përgjatë hapave pozitivë të dialogut, si dhe reformat e sundimit të ligjit.

Si përfundim, pjesëmarrësit thanë se drejtimi i dialogut Kosovë-Serbi varet nga kush fiton zgjedhjet presidenciale të nëntorit në SHBA. Një administratë e rizgjedhur e Trump do të vazhdonte lëvizje të ngjashme simbolike, jokoherente që nuk na sjellin më pranë një marrëveshjeje. Përndryshe, një administratë e udhëhequr nga Biden do të punonte së bashku me partnerët evropianë, duke rivendosur linjat e kuqe në opsionet destabilizuese dhe në fund të fundit

të na afronte me pranë një marrëveshjeje. Roli i shoqërisë civile në Serbi dhe Kosovë në promovimin e një marrëveshje paqeje dhe vlerash demokratike është i pazëvendësueshëm, sidomos kur shumë sektorë të rëndësishëm të shoqërisë civile - të tillë si mediat dhe universitetet—janë nën kontrollin e qeverisë, sugjeruan shumica e pjesëmarrësve.

Pjesëmarrësit

Jennifer Brush, Ish-Ambasadore; Ish-Drejtoreshë, Zyra për Evropën Jugore-Qendrore, Departamenti i Shtetit, SHBA; Ish-Zëvendës-Përfaqësuese Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë

Steven Burg, Kryetar, Bordi i Drejtorëve, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse; Profesor, Universiti Brandeis

Robert Cooper, Ish-këshilltar, Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm

Thomas Countryman, Anëtar, Bordi i Drejtorëve, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse; ish-ndihmës sekretar, Departamenti i Shtetit, SHBA

Greg Delawie, Ish-Ambasador i SHBA-ve në Kosovë

Shpetim Gashi, Nënpresident, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

Sebastien Gricourt, Drejtor, Observatori Ballkanik, Fondacioni Jean Jaures; Këshilltar për Çështje Ndërkombëtare dhe të Mbrojtjes, Partia Socialiste (Francë)

Stephen Heintz, President, Fondi i Vëllezërve Rockefeller

Jean-Hubert Lebet, Ish-Ambasador i Zvicrës në Kosovë

Pierre Mirel, Anëtar, Bordi i Drejtorëve, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse; Drejtor i Përgjithshëm Nderi, Komisioni Evropian

Cameron Munter, Ish-Ambasador i SHBA-ve në Serbi

Igor Novakovic, Bashkëpunëtor në Serbi, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

Alex Roinishvili Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

Joachim Ruecker, Ish-Shef i Misionit të OKB-së në Kosovë

Kyle Scott, Ish-Ambasador i SHBA-ve në Serbi

Karsten Voigt, Ish Koordinator i Marrëdhënieve Gjermani-Amerikë Veriore, Zyra Gjermane për Punë të Jashtme; Ish-Drejtor, Asambleja Parlamentare e NATO-s

Mia Vukojevic, Drejtoreshë Programi, Ballkani Perëndimor, Fondi i Vëllezërve Rockefeller

Hoyt Yee, Ish-Zëvendës Ndhmës Sekretar, Departamenti i Shtetit, SHBA

Samuel Zbogor, Ish-Ministër i Jashtëm i Sllovenisë; Ish-Shef i Zyrës së BE-së dhe Përfaqësues Special i BE-së në Kosovë